



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT GJENERAL/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Dokumenti Nr: 21.4.9-2008-08

**RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS NË
SHPËRNDARJEN E BARNAVE ESENCIALE NGA
DEPARTAMENTI FARMACEUTIK-MINISTRIA E
SHËNDETËSISË**

Prishtinë, 26 Qershor 2009

LETËR PËRCJELLËSE

Data:26/06/2009

I nderuar, Ministër i MSH-se Alush GASHI,

Kam kënaqësinë të ju njoftoj me qasjen e re të auditimit e cila vetëm sa ka filluar të praktikohet nga zyra ime- auditimi i performancës.Gjatë kryerjes së auditimit të performancës ne e ekzaminojmë mënyrën se si institucioni i ka shfrytëzuar burimet në kryerjen e detyrave të saja.Auditimi i performancës përqendrohet në një program ose funksion specifik dhe kërkon ta përcaktojë shkallën në të cilën janë përmbushur objektivat e programit (efektiviteti),dhe nëse kjo është arritur në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Luteni të gjeni të bashkangjitur raportin tim final të auditimit të performancës lidhur me programin farmaceutik në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë e cila përfshin periudhën e vitit 2008.

Në pajtim me kërkesat ligjore ky raport do të publikohet. Si përgjigje në këtë, unë pres një raport nga ju brenda 30 ditësh, i cili raport i drejton masat e planifikuara për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në raportin tonë, duke përfshirë masat të cilat ju planifikoni t'i ndërmerri.

Unë e vlerësoj lartë bashkëpunimin dhe sjelljen e treguar ndaj personelit tim gjatë auditimit. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm mendon të bashkëpunojë me ju edhe në të ardhmen.

Cc: Sekretar Permanent,Haxhi KAMBERI

Cc: Kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa,Gani KOCI

Cc: Kryetar i Komisionit për Shëndetësi,Punë dhe Mirëqenie Sociale,Sadik IDRIZ

Cc: Drejtori i Departamentit Farmaceutik,Lutfi MULAKU

Sinqerisht i Juaji,

Lars Lage OLOFSSON

Auditor Gjeneral

PËRMBAJTJA

	LISTA E SHKURTESAVE	4
I	Përmbledhje Ekzekutive	5
II	Historiku	7
III	Objektiva studiuese dhe çështjet kryesore	7
IV	Fushë veprimi i auditimit	7
V	Metodologjia	8
VI	Të Gjeturat	8-12

LISTA E SHKURTESAVE

DF	Departamenti Farmaceutik
KFK	Korporata Farmaceutike e Kosovës
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosoves
MSH	Ministria e Shëndetësisë
UA	Udhëzim Administrativ
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral

I. Përmbledhja Ekzekutive

Departamenti Farmaceutik (DF), në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, është përgjegjës për menaxhimin e furnizimit dhe shpërndarjes së barnave nga 'lista esenciale' tek institucionet shëndetësore për shpërndarjen e mëtejme tek pacientët. Buxheti i ndarë për këtë program gjatë vitit 2008 ka qenë 15 milion €uro.

Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) ka kryer auditimin e performancës të këtij programi me objektivën e përcaktimit nëse është menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive. Auditimi përqendrohet në tri çështje kryesore:

- Nëse barnatoret e Spitaleve pranojnë dhe mbajnë furnizime të mjaftueshme (sipas llojit dhe sasisë) të barnave nga lista esenciale;
- Nëse ka kontrole të përshtatshme në kuadër të barnatoreve të spitaleve në lidhje me pranimin, magazinimin dhe shpërndarjen të barërave esenciale tek pacientet;
- Nëse Zyrtarët nga Ministria së Shëndetësisë i hetojnë mosdhënien e raportuar të barnave nga 'lista esenciale'.

Të gjeturat kryesore

Auditimi ka gjetur dobësi në të gjitha aspektet e programit, duke ngritur rrezikun që barnat esenciale të mos jenë në dispozicion për pacientet kur iu nevojiten. Në veçanti:

- Ekzistojnë mospërputhje serioze ndërmjet sasive të vlerësuara të barnave esenciale të nevojshme për çdo vit dhe sasive aktuale të dhëna dhe sasive aktualisht të kërkuara nga institucionet shëndetësore;
- Barnatoret i dërgojnë kërkesat direkt tek kompania private për shpërndarjen (KFK) në vend të operimit nëpërmjet Departamentit Farmaceutik, dhe kjo rezulton në atë që Departamenti Farmaceutik nuk mund të menaxhojë dhe kontrollojë si duhet procesin e shpërndarjes;
- Barnatoret nuk i marrin sasitë e kërkuara të barnave esenciale, me sa duket për shkak të mungesës së barnave në dispozicion në depon qendrore;
- Nuk ka qasje sistematike për porositjen e sasive të reja të barnave, duke e rritur rrezikun që barnat të mos jenë në dispozicion për pacientët kur ata kanë nevojë;
- Ekzistojnë dobësitë në kontrollin e mbajtjes së barnave dhe formën e shpërndarjes nga depoja qendrore ashtu që ekziston një ndarje joadekuate e detyrave;
- Zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë nuk bëjnë inventarizimin periodik të barnave që mbahen në depon qendrore;
- Objektet për ruajtjen e barnave në QKUK janë të standardit të ulët duke e rritur rrezikun e prishjes së barnave;
- Ekzistojnë kontrole të pamjaftueshme lidhur me shpërndarjen fizike të barnave tek pacientët;
- Në fund të fundit këto të gjetura krijojnë një mjedis të prirur kah rreziku, p.sh. rreziqet për kalimin e barnave tek pacientët jashtë sistemit zyrtar të shëndetësisë; korrupsioni dhe në përgjithësi keqmenaxhimi.

Rekomandimet

Ne i rekomandojmë Ministrin të Shëndetësisë të iniciojë një analizë më të thellë të problemeve të theksuara në këtë raport dhe një program të zhvillimit me synim të përmirësimit të shpërndarjes së barnave nga lista esenciale, dhe i drejton këto rekomandime vijuese:

1. Ministria e Shëndetësisë, në bashkpunim me institucionet shëndetësore, duhet të bejnë një planifikim më të mire dhe më të saktë lidhur me nevojat reale vjetore për barnat të listës esenciale.
2. Të gjitha kërkesat e bëra nga institucionet shëndetësore për furnizim me barna nga lista esenciale duhet të aprovohen nga Departamenti Farmaceutik para se të dërgohen tek kompania e kontraktuar për shpërndarjen e tyre.
3. Departamenti Farmaceutik duhet të hetoj arsyet për dështimet e dukshme në zinxhirin furnizues të barnave esenciale.
4. Departamenti Farmaceutik duhet të nxjerr udhëzime për porositjen e barnave, përfshirë instruksionet për kalkulimin e nivelit të ri-kërkesës për çdo lloj medikamenti duke u bazuar në mesataren e përdorimit dhe kohën e drejtimit (procedimi i porosisë dhe dërgesës).
5. Departamenti Farmaceutik duhet të siguroj që ndarja adekuate e detyrave është prezantuar dhe kështu një individ nuk e ka pothuajse plotësisht kontrollin mbi operimin e depon qendrore.
6. Departamenti Farmaceutik duhet të siguroj që inventarizimi i pavarur i barnave esenciale në depon qendrore është kryer rregullisht.
7. Autoritetet në Qendrën Klinike të Universitetit të Kosovës (QKUK) duhet të ndërmarrin veprime për ta sjell depon në kushtet e pranueshme sipas standardeve për ruajtjen e barnave
8. Ne rekomandojmë që si pikënisje ne forcimin e procesit duhet të jetë që te mbahen regjistrime se cilat barna dhe ne qfar sasive dhe çmimi jane derguar te çdo pacient.

II. Historiku

Ligji Nr. 03/L-075, Neni 3.4 siguron Auditorin Gjeneral për të kryer auditimin e performancës në Ministrinë e Shëndetësisë (përcaktuar në Artikullin 3.2 të ligjit si Ministri e Republikës së Kosovës). Në kryerjen e auditimit të performancës, Auditori Gjeneral ekzaminon mënyrën se si Ministria ka përdorur burimet e saj në kryerjen e detyrave të saj. Auditimi i performancës fokusohet në program apo funksion specifik dhe kërkon të përcaktoj nivelin në të cilin objektivat e programit janë realizuar (efektshmëria) dhe nëse janë bërë në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Departamenti Farmaceutik, brenda Ministrisë së Shëndetësisë, është përgjegjëse për menaxhimin e furnizimit dhe shpërndarjes së barnave nga 'lista esenciale' në institucionet shëndetësore për më tutje duke i shpërnda tek pacientet. Ky aktivitet është kryer në pajtim me Instruksionin Administrativ Nr. 2007/11 (bazuar në Ligjin e Shëndetësisë Nr. 2004/4 shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Rregullorja Nr. 2004/31 efektive nga data 27 Dhjetor 2007). Buxheti i përcaktuar për programin për vitin 2008 ishte 15 milion euro. Lista esenciale është hartuar dhe aprovuar në baza të rregullta nga komisioni brenda Ministrisë së Shëndetësisë, dhe në kohën e auditimit tonë përfshinë 168 lloje të barnave.

III. Objektiva Studiuëse dhe çështjet kryesore

Objektiva e auditimit të performancës ka qenë të përcaktoj nëse sistemi për furnizimin dhe shpërndarjen e barnave nga 'lista esenciale' është menaxhuar dhe kontrolluar si duhet për të siguruar që barnat e përshkruara janë shpërndarë tek pacientet sipas nevojës. Brenda kësaj ne kemi ekzaminuar:

- Nëse barnatoret e spitalit pranojnë dhe mbajnë furnizime të mjaftueshme (sipas llojit dhe sasisë) të barnave nga lista esenciale;
- Nëse eksitojnë kontrollet adekuate në barnatoret e spitalit mbi pranimin, deponimin dhe shpërndarjen e barnave nga 'lista esenciale';
- Nëse Zyrtarët nga Ministria e Shëndetësisë hetojnë raportimet e mos-furnizimit të barnave nga 'lista esenciale'.

IV. Fushëveprimi i Auditimit

Fushëveprimi i studimit ka qenë i kufizuar në rregullimet e vendosur nga Departamenti Farmaceutik për shpërndarjen e barnave nga depoja qendrore nëpër institucionet e shëndetësisë dhe që këto institucione ti ruajne/mbajnë dhe t'ju japin barnat pacienteve. Studimi nuk ka shikuar veprimet që janë bërë për specifikimin e barnave të përfshira në 'listën esenciale', gjithashtu nuk ka ekzaminuar marrëveshjet e blerjes së barnave.

Studimi ka ekzaminuar aranzhimet/veprimet në dy institucione shëndetësore- Qendren Klinike Universitare në Prishtinë dhe Spitalin Regjional të Gjilanit.

V. Metodologjia

Metodologjia e studimit ka përfshirë rishikimin e sistemeve dhe kontrolleve, ekzaminimin e dokumenteve, testimin e transaksioneve të selektuara, dhe intervisimin e personelit.

Detyrat specifike të kryera kanë qenë:

- Rishikimi i rregulloreve dhe praktikave ekzistuese për administrimin dhe shpërndarjen e barnave esenciale;
- Harmonizimin e të dhënave lidhur me barnat e dhëna nga depoja qendrore dhe te pranuar nga institucionet shëndetësore;
- Përcjellja e kufizuar e selektimit të barnave gjatë procesit (sistemit) të shpërndarjes;
- Ekzaminimi i lokacioneve të deponimit në dy institucionet shëndetësore të vizituara;
- Rishikimi i procedurave për shpërndarjen e barnave esenciale nga barnatoret e spitaleve tek pacientët dhe ekzaminimin e dëshmime mbështetëse;
- Intervistimi i zyrtarëve relevant në depon qendrore dhe dy institucionet shëndetësore të vizituara.

VI. Të gjeturat e auditimit

Ekzistojnë mospërputhje serioze ndërmjet sasive të vlerësuara të barnave esenciale të nevojshme për çdo vit dhe sasive aktuale të dhëna dhe sasive aktualisht të kërkuara nga institucionet shëndetësore.

- Ne kemi kërkuar nga Departamenti Farmaceutik nëse Komisioni i cili përcakton dhe vlerëson kërkesën vjetore të barnave specifike të 'listës esenciale', i merrë për bazë për kryerjen e planifikimit të saj, nevojat indikative të përgatitura nga secili institucion shëndetësor. Për mostrat e 30 barnave, ne kemi krahasuar kërkesat e llogaritura vjetore të bëra sipas institucionit shëndetësor dhe sasive të regjistruara nga Ministria e Shëndetësisë.

Rezultatet e këtij testi kanë zbuluar dallime të mëdha.

- Ne kemi hasur në raste, sikurse të shfaqura në tabelën më poshtë, ku Departamenti Farmaceutik ka ngritur në mënyrë të theksuar planifikimet vjetorë të kërkesave të paraqitur nga QKUK për vitin fiskal 2008.

Barnat në Listën Esenciale	Planifikimi i QKUK-se	Planifikimi i DF për QKUK	Ngritja (%)
Adenosine ampoule 3mg/ml	1,940	80,000	4,123
Pancuronium Bromid nj. 2mg/ml	11,000	30,000	172
Oxytocin amp.10 IU/ml	26,220	40,000	53

Ka rrezik që ky nivel i mbi- planifikuar do të ketë rezultuar në sasi të mëdha të stoqeve të

këtyre llojeve të barnave, sipas të gjitha gjasave duke rezultuar në prishjen e tyre, ndërsa mjetet për blerjen e barnave tjera janë zvogëluar.

- Në gjithashtu kemi hasur në mospërputhje serioze në Barnatoren Qendrore të QKUK-së ndërmjet sasive të barnave të planifikuara si të nevojshme për vitin 2008 dhe sasive aktualisht të kërkuara nga depoja qendrore gjatë vitit. Mospërputhja më serioze (për tri lloje të barnave) është paraqitur në tabelën më poshtë

Barnat në Listen Esenciale	Sasia e Planifikuar	Sasia e kërkuar	Shkurtime (%)
Acetylsalicylic Acid 100mg tab	155,265	36,000	77
Amoxycilin 500mg	80,620	19,000	76
Gentamycin inj.80mg/2ml	142,325	50,200	65

- Përderisa mund të ketë arsye valide për sasinë e pakta të këtyre barnave aktualisht të kërkuara në vitin 2008, përmasa e sasive të pakta sugjeron që kërkesa e vlerësuar nuk është bazuar në të dhëna të besueshme të shfrytëzimit në vitet paraprake, e as lidhur me “nevojat aktuale”.
- Menaxhmenti i barnatores më pas ka këshilluar ekipin e auditimit që ata janë të njoftuar që barnat nuk janë në dispozicion në depon qendrore prandaj e kanë zvogëluar sasinë e kërkuar. Kjo praktikë e rrit rrezikun që barnat esenciale të mos jenë në dispozicion për pacientët dhe rezulton me informacione të pasakta të ofruara lidhur me nevojën fizike për barnat. Është esenciale që kjo situatë të analizohet më thellë me qëllim që të gjinden mekanizma më efektive për alokimin e tyre. Në gjithashtu kemi kërkuar të konfirmojmë nëse zbatimi i planifikimit vjetor të Komisionit është kryer me kohë. Planifikimi është bërë për çdo vit fiskal, por realizimi nuk është kompletuar deri sa ka filluar viti i ri. Për shembull, planifikimi i nevojave vjetore për Janar- Dhjetor 2008 është kompletuar në Prill 2008, diku katër muaj pas fillimit të vitit. Si rezultat, ekziston rreziku që furnizimet me barna esenciale nuk janë në dispozicion me kohë për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit për institucionet shëndetësore.

Konkluzion: Vleresimet nga Departamenti Farmaceutik dhe institucionet shëndetësore për sasinë aktuale të barnave esenciale të nevojshme për secilin vit janë të dyshimta dhe nuk janë të bazuara në ndonjë analizë sistematike të përdorimit.

Rekomandimi nr.1 Ministri i Shëndetësisë, në bashkëpunim me institucionet shëndetësore, duhet të bëjë një vlerësim-planifikim më të mirë dhe më të saktë lidhur me nevojat reale vjetore për barnat të listës esenciale.

Barnatoret dërgojnë kërkesa direkte tek kompania shpërndarëse (KFK) në vend të operimit nëpërmjet Divizionit Farmaceutik

- Instruksionit Administrativ i Departamentit Farmaceutik (Nr. 2007/11) tregon hapat që duhet të përcillen për institucionet shëndetësore për të porositur barna esenciale. Në mënyrë specifike, sipas nenit 11.3 dhe 11.4 të Instruksionit, kërkesa nga institucionet shëndetësore për furnizimin me barna esenciale duhet të paraqitet për aprovim në Departamentin Farmaceutik. Kjo mundëson Departamentin të monitoroj dhe kontrolloj volumin e barnave të furnizuara tek institucionet shëndetësore në gjithë Kosovën.

- Ne kemi gjetur, megjithatë që kërkesat për barna ndonjëherë janë dërguar direkt tek kontraktori privat (KFK) në depon qendrore në Mazgit. Gjithashtu ishte e qartë, nga diskutimet me zyrtarët dhe rishikimet tona në dokumentet relevante, se sasia e barnave për tu furnizuar institucionet shëndetësore janë aprovuar nga KFK dhe vetëm me nënshkrim dytësore nga Departamenti Farmaceutik.

Konkludim: Kjo praktik pengon Departamentin Farmaceutik në ushtrimin e menaxhimit efektiv dhe kontrollin mbi sasinë e barnave të porositura dhe dërguara tek institucionet individuale të shëndetësisë. Por po ashtu tregon që roli i DF duhet të sqarohet nga vet ata në dialogun me hisedaret e tjere.

Rekomandimi nr.2 Të gjitha kërkesat e bëra nga institucionet shëndetësore për furnizimin e barnave esenciale duhet të aprovohen nga Departamenti Farmaceutik para se ato të janë dërguar për veprim tek kompania private për shpërndarje.

Barnatoret nuk pranojnë sasinë e porositur të barnave esenciale

- Ne kemi kërkuar të kuptojmë deri në cilën masë sistemi i furnizimit ekzistues është i gatshëm të përmbush kërkesat e institucioneve shëndetësore për barna.

- Gjatë diskutimit me Drejtorin e Depos Qendrore në QKUK, na është thënë se kërkesat e spitalit rrallë janë përmbushur plotësisht- sasia e furnizuar shpesh ka qenë më pak se e kërkuara.

- Duke u bazuar në raportet vjetore të përgatitura nga barnatorja qendrore e QKUK-së ne kemi krahasuar sasinë e kërkuar me sasinë e furnizuar për 30 mostra (barna) (prej 168) gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2008. Vetëm në 60% të rasteve kanë pranuar barnat e kërkuara. Neve na është thanë se arsyeja për shkurtrimin e kërkesës ka qenë sepse nuk ka pasur furnizime të mjaftueshme në depon qendrore.

Konkludim: Sistemi ekzistues për shpërndarjen e barnave esenciale në institucionet shëndetësore nuk siguron që ato janë dërguar me sasinë që ato e kanë kërkuar.

Rekomandimi nr.3 Departamenti Farmaceutik duhet të hetoj arsyet për dështimet e dukshme në zinxhirin furnizues për barna esenciale.

Nuk ka qasje sistematike për porositjen e furnizimit të ri të barnave

- Është e rëndësishme që barnat esenciale të ri- porositen para se furnizimet ekzistuese të janë harxhuar dhe se kërkesa është bërë mjaft kohe përpara që kjo të mundësoj kohë që kërkesa të procedohet dhe barnat të dërgohen tek institucioni shëndetësor.

- Nga diskutimet dhe rishikimet tona në udhëzuesin ekzistues, është e qartë se nuk ka instruksione për të ndihmuar institucionet shëndetësore për të përcaktuar deri në cilën masë të bëhet porosia e re e barnave . Për përzgjedhjen e porosisë, ne kemi analizuar nivelin e mbetjes së stoqeve në masën që është bërë kërkesa, dhe në secilin rast ka qenë zero.

Konkludim: Institucionet Shëndetësore nuk mbajnë minimumin e stoqeve (ose stoqet rezervë) duke rritur rrezikun që barnat esenciale të mos jenë në dispozicion për pacientet kur iu nevojiten.

Rekomandimi nr.4 Departamenti Farmaceutik duhet të nxjerr udhëzime për porositjen e barnave, përfshirë instruksionet për kalkulimin e nivelit të ri-kërkesës për çdo lloj medikamenti duke u bazuar në mesataren e përdorimit dhe kohën e drejtimit (procesi I porosisë dhe dërgesës).

Ekzistojnë dobësitë në kontrollin e mbajtjes së barnave dhe formën e furnizimit nga depoja qendrore në atë se ekziston një ndarje joadekuate e detyrave.

- Ne kemi ekzaminuar veprimet për furnizimin me barna nga depoja qendrore për të përcaktuar nëse aktiviteti është mjaft mirë i kontrolluar (për të parandaluar humbjet, vjedhjet etj), Në veçanti, ne kemi rishikuar alokimin e përgjegjësive për të përcaktuar nëse ka ndarje të detyrave në mënyrë të mjaftueshme ndërmjet procesit fizik të përfshirë në depo dhe shpërndarjes së barnave dhe funksionimit të menaxhimit mbikëqyrës.

- Ne kemi vërejtur se aty ka ndarje jo adekuate të detyrave sepse i njëjti zyrtar brenda Departamentit Farmaceutik është përgjegjës për mbikëqyrjen e pranimit të barnave në depo, autorizimin e dhënies së barnave nga depoja, dhe mbikëqyrjen e gjithë procesit të shpërndarjes.

Konkludim: Kjo ndarje e detyrave në mënyrë jo adekuate vë në rrezik serioz shpërndarjen e barnave.

Rekomandimi nr.5 Departamenti Farmaceutik duhet të sigurohet se është bere ndarja adekuate e detyrave , kështu që një individ nuk e ka plotësisht kontrollin mbi operimin e depon qendrore.

Zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë nuk bëjnë inventarizimin periodik të barnave që mbahen në depon qendrore

- Instruksioni Administrativ (Nr 11/2007) përcakton, në nenin 22.2, se Ministria e Shëndetësisë duhet të bëjë dy herë inventarizimin gjatë vitit për produktet farmaceutike të vendosura në depon qendrore.
- Gjatë diskutimit më zyrtarët relevant, na është thënë se nuk është bërë inventarizimi nga Ministria e Shëndetësisë në fund të vitit 2007. Kontraktori Privat (KFK) ka bërë inventarizimin për qëllime të veta, po kjo nuk ka qenë në prezencën e zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë. Dhe në kohën e auditimit tonë nuk ka ndodhur inventarizimi gjatë vitit 2008, edhe pse më vonë na është thënë se një inventarizim ka ndodhur pasi që ne kemi kompletuar punën në terren.

Konkludim: Mungesa e inventarizimit të rregullt ulë nivelin e kontrollit të menaxhmentit mbi barnat e vendosura në depo dhe ngrit rrezikun e vjedhjes dhe keqpërdorimit të barnave.

Rekomandimi nr.6 Departamenti Farmaceutik duhet të siguroj që inventarizimi i pavarur i barnave esenciale në depon qendrore kryhet rregullisht.

Ndërtesa e deponimit farmaceutik në QKUK nuk është plotësisht sipas standardeve

- Barnat duhet ruajtur në mjedis të kontrolluar për tu siguruar se ato qëndrojnë për përdorim për 'afatin e caktuar' në to. Çdo ndërtesë deponimi duhet të jetë e siguruar (me gasje të kufizuar), higjienike, e mbrojtur nga uji, dhe temperaturë të kontrolluar.

- Përderisa në Barnatoren Qendrore të QKUK-së, ne kemi vizituar të gjithë fushat ku mbahen barnat dhe kemi vërejtur se kushtet e këtyre fushave të deponimit janë nën standardet e kërkuara për ruajtjen e barnave. Përderisa depot ishin të siguruara, kushtet fizike ishin shumë të dobëta, duke përfshirë rrjedhjen nga tavani, dhe ambienti me lageshti dhe jo higjienik.

- Depoja qendrore në Mazgit dhe depoja e vendosur në Spitalin regional të Gjilanit ishte në kushte më të mira.

Konkludim: Deponimi në kushtet nën standarde ngrit rrezikun që barnat do të prishen dhe do të duhet të hidhen, duke rezultuar në shpërdorim të burimeve.

Rekomandimi nr.7 Autoritetet në Qendren Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) duhet të ndërmarrin veprime për ta sjell depon në kushtet e pranueshme sipas standardeve për ruajtjen e barnave.

Kontrolle të pamjaftueshme në shpërndarjen fizike të barnave tek pacientet

- Është e rëndësishme që proceset fizike për shpërndarjen e barnave tek pacientët të kontrollohen dhe dokumentohen mirë

- Nga intervistat e kryera me zyrtarët relevant dhe ekzaminime të të dhënave, ne kemi vërejtur se procesi i shpërndarjes së barnave tek pacienti nuk është regjistruar mjaftueshëm.

- Testet e kryera tregojnë që procesi i shpërndarjes së barnave prej institucioneve shëndetësore të pacientët nuk janë regjistruar si duhet. Dobesite e vërejtura lidhen me identifikimin dhe regjistrimin e barnave në atë mënyrë që të monitorohen shpenzimet e barnave.

Konkludim: Regjistrimi jo adekuat i barnave dhënë pacienteve ngrit rrezikun e përdorimit të pavend të barnave, dhe po ashtu vështirëson ndonjë hetim pasues duke larguar 'gjurmët e auditimit' ndërmjet të dhënave të pacientit dhe barnave të ofruara.

Rekomandimi nr.8 Ministri i Shëndetësisë rekomandohet që të inicioj një analizë të përgjithshme të procesit të shpërndarjes së barnave të pacientet dhe në bazë të saj të merr masa me qëllim të sigurimit të kualitetit në procesin e shpërndarjes. Ne rekomandojmë që si pikënisje në forcimin e procesit duhet të jetë që të mbahen regjistrime se cilat barna dhe në qfar sasi dhe çmimi janë dërguar te qdo pacient.

Konkluzioni dhe Rekomandimi jonë i Përgjithshëm është:

Që Ministri i Shëndetësisë duhet të iniciojë një analizë më të thellë të problemeve të theksuara në këtë raport dhe një program të zhvillimit me synim të përmirësimit të shpërndarjes së barnave nga lista esenciale.

